FLETËUDHËZUES I PAKETIMIT:
Informacion për pacientin

Neuro B

Tretësirë për injeksion
(100 mg + 50 mg + 0.5 mg) / 2 ml
(Vitamin B1 + Vitamin B6 + Vitamin B12)

Lexojeni me kujdes këtë fletëudhëzues përpara se të filloni përdorimin e barit.
- Ruajeni këtë fletëudhëzues. Mund të keni nevojë ta lexoni përsëri.
- Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.
- Ky bar është përshkruar për ju. Mos e jepni tek persona të tjerë. Mund t'i dëmtojë ata edhe pse mund të kenë të njëjtat simptoma si ju.
- Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore përkeqësohet ose në qoftë se vëreni ndonjë efekt tjetër anësor që nuk përmendet në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

Në këtë fletëudhëzues:

1. Çfarë është Neuro B dhe përse përdoret?
2. Përpara se të merrni Neuro B
3. Si ta merrni Neuro B?
4. Efekte anësore të mundshme
5. Si ta ruani Neuro B?
6. Informacion i mëtejshëm

1. ÇFARË ËSHTË NEURO B DHE PËRSE PËRDORET

Neuro B përmban si lëndë aktive Vitaminë B1 (tiaminë klorhidrat), Vitaminë B6 (piridoksinë klorhidrat) dhe Vitaminë B12 (cianokobalamin) të cilat janë pjesë e vitaminave të grupit B.
Këto vitamina hyjnë në përbërjen e enzimave që katalizojnë reaksionet gjatë metabolizmit të sheqernave, yndyrnave dhe proteinave. Kombinimi i vitaminave të grupit B përdoret për ndikimin në një sërë procesesh dhe funksionesh të rëndësishme të organizmit dhe kryesisht për ndikimin mbi sëmundjet inflamatore dhe degjenerative të nervave dhe aparatit motorik.
Neuro B, si tretësirë për injeksion, përdoret në mjekimin kompleks të sëmundjeve dhe gjendjeve të mëposhtme:
- në trajtimin e mungesës së vitaminave B, në dermatite, ekzema, psoriazë, diatezë eksudative, akne;
- proçese inflamatore dhe degjenerative të nervave periferike – neurite, polineurite (alkoolike, postinfektive dhe toksike, në rast diabeti), neuralgji, mialgji, parestezi;
- gjatë trajtimit me disa barna si izoniazid, cikloserinë;
- në trajtimin e anemisë makrocitare;
- mund të jetë i dobishëm si ndihmës në manaxhimin e abstinencës së alkolit;
- pas gastroektomisë ose pas heqjes masive të ileumit;
- mund të ndikojë pozitivisht në rregullimin e sindromës premenstruale.

2. PËRPARA SE TË MERRNI NEURO B

Mos merrni Neuro B në qoftë se:
- keni mbindjeshmëri (alergji) ndaj ndonjërit prej përbërësve aktivë apo përbërësve të tjerë të Neuro B sepse mund të ndodhin reaksione anafilaktike;
- jeni shtatzënë;
- vuani nga policitemia vera;
- vuani nga proçeset malinje;
- vuani nga tromboembolia akute (bllokimi i një ene gjaku nga formimi i trombit);
- vuani nga eritroza dhe eritremia (sëmundje të gjakut me numër të rritur të eritrociteve).
- keni sëmundjen Leber apo ambliopatinë e duhanit sepse këto neuropati optike mund të përkeqësohen më tej.

Tregoni kujdes të veçantë me Neuro B
Neuro B duhet të përdoret me kujdes nga pacientët me forma të rënda ose akute të insufiçiencës së dekompensuar kardiake dhe me stenokardi.
Përdorimi i zgjatur i dozave të larta të piridoksinës shoqërohet me zhvillimin e neuropatisë periferike të rëndë; doza në të cilën shfaqet kjo është e diskutueshme.
Cianokobalamina, nëse është e mundur, duhet të mos jepet tek pacientët e dyshuar për mungesë të vitaminës B12 pa e konfirmuar paraprakisht diagnozën. Monitorimi i rregullt i gjakut është i kështillueshëm. Përdorimi i dozave ditore më të mëdha se 10 mikrogram mund të shkaktojë përgjigje hematologjike në pacientët me mungesë të folateve; përdorimi jo i rregullt mund të maskojë diagnozën e saktë. Në anën tjetër, folatet mund të maskojnë mungesën e vitaminës B12.

Marrja e barnave të tjera
Tregojini mjekut ose farmacistit tuaj nëse jeni duke marrë, keni marrë kohët e fundit ose mund të merrni ndonjë bar tjetër, përfshirë barnat të cilat merren pa recetë.

Barnat që mund të ndërveprojnë me Neuro B janë:
bllokuesit neuromuskularë: vitamina B1 mund të rrisë efektin e bllokuesve neuromuskularë;
levodopa: vitamina B6 redukton efektet e levodopës, por kjo nuk shfaqet nëse njëkohësisht jepet një frenues i dopadekarboksilazës;
fenobarbitali: është raportuar që vitamina B6 ul përqëndrimin e fenobarbitalit në serum;
hidralazina, izoniazidi, penicilamina dhe kontraceptivët oralë mund të rrisin nevojën për vitaminë B6;
kloramfenikoli: kloramfenikoli në rrugë parenterale mund të pakësojë efektin e vitaminës B12 në anemi.

Marrja e Neuro B me ushqim dhe pije
Nuk ka të dhëna për nevojën e një diete të veçantë ushqimore ose të kufizimit të llojeve të caktuara ushqimesh dhe pijesh në kohën e mjekimit me këtë produkt.

Shtatzënia dhe Ushqimi me gji

Shtatzënia
Njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se jeni shtatzënë, dyshoni se jeni shtatzënë ose po planifikoni të mbeteni shtatzënë.
Vitamina B6 dhe B12 kalojnë barrierën placentare, kështu që nuk rekomandohet përdorimi i Neuro B gjatë shtatzënisë.

Ushqimi me gji
Njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se ushqeni foshnjen me qumësht gjiri.
Nënat me defiçiencë të theksuar të tiaminës duhet të mënjanojnë ushqyerjen me gji për shkak të prezencës së metil-glioksalit toksik në qumësht.
Nuk rekomandohet të përdoret në këtë periudhë, përveç rasteve të domosdoshme.

Drejtimi i automjetit dhe përdorimi i makinerive
Nuk janë bërë studime mbi ndikimin e këtij bari në aftësinë për të drejtuar automjete apo përdorur makineri.

3. SI TA MERRNI NEURO B

Gjithmonë merreni Neuro B sipas kështillës së mjekut. Në qoftë se nuk jeni i sigurt, kontaktoni me mjekun ose farmacistin tuaj.
Dozat e zakonshme përshkruhen më poshtë:
Tek të rriturit, injektohen në muskul 2 ml 1-2 herë në ditë. Zgjatja e mjekimit bëhet sipas vlerësimit të mjekut.
Tek fëmijët përshtatet doza sipas moshës dhe sëmundjes.

Në qoftë se keni marrë më shumë Neuro B
Në qoftë se keni marrë më shumë Neuro B se sasia që duhet të merrnit, ose në qoftë se fëmijët e kanë marrë gabimisht këtë bar, ju lutemi të kontaktoni mjekun tuaj, spitalin ose të telefononi urgjencën për të marrë një mendim për rrezikun dhe kështillë për veprimet që duhet të ndërmerren.
Mos merrni më shumë Neuro B se sasia që ju rekomandon mjeku juaj.
Në raste të rralla mund të ndodhë shok anafilaktik fatal.
Vitamina B6 zakonisht nuk është toksike, përdorimi kronik i dozave të larta është shoqëruar me efekte anësore neurologjike.
Vitamina B12 zakonisht nuk është toksike edhe në doza të larta, megjithatë është raportuar diarre e lehtë tranzitore, trombozë periferike vaskulare, ekzantemë tranzitore me kruajtje, urtikarie, ndjesi enjtjeje e të gjithë trupit, anafilaksi, dhe vdekje tek pacientët me përdorim parenteral të vitaminës B12.

Trajtimi
Izoniazidi është një antidot i Vitaminës B6.

Në qoftë se keni harruar të merrni Neuro B
Mos merrni një dozë të dyfishtë për të plotësuar dozën e harruar.
Në qoftë se keni harruar të merrni Neuro B, merrni dozën tuaj sa më shpejt që të kujtoheni përveç rastit kur ka ardhur koha që të merrni dozën pasardhëse. Përdorni dozat në kohën e duhur.

4. EFEKTE ANËSORE TË MUNDSHME

Si të gjitha barnat e tjera, Neuro B mund të shkaktojë efekte anësore, megjithëse jo çdokush i manifeston.
Neuro B në dozat e rekomanduara nuk jep efekte anësore.
Në raste të rralla mund të vihen re: djersitje, takikardi, kruarje, urtikarie.
Efektet anësore të tiaminës janë të rralla, por janë shfaqur reaksione mbindjeshmërie deri në shok anafilaktik fatal.
Pas injektimit intramuskular të Neuro B mund të vërehet ndjeshmëri e shtuar dhe ngurtësim, djegie ose shpim në vendin e injektimit.
Përdorimi i zgjatur i dozave të larta të vitaminës B6 shoqërohet me zhvillimin e neuropatisë periferike të rëndë; doza në të cilën shfaqet kjo është e diskutueshme. Lajmëroni mjekun ose farmacistin tuaj nëse ju shfaqen këto efekte anësore, ose çdo efekt anësor tjetër që nuk përmendet në këtë fletëudhëzues.

5. SI TA RUANI NEURO B

Mbajeni larg fëmijëve!
Mos e përdorni Neuro B pas datës së skadencës e cila është e shënuar në paketim.
Ruajeni në vend të thatë, të freskët, në temperaturë jo më shumë se 25°C!
Mos e ruani në ngrirje.
Ruajeni Neuro B nga drita dhe nga lagështia!

6. INFORMACION I MËTEJSHËM

Çfarë përmban Neuro B – tretësirë për injeksion
Lëndët vepruese janë: vitaminë B1 (tiaminë klorhidrat), vitaminë B6 (piridoksinë klorhidrat), vitaminë B12 (cianokobalamin).
Çdo ampulë 2 ml përmban 100 mg vitaminë B1, 50 mg vitaminë B6 dhe 0.5 mg vitaminë B12.
Përbërës të tjerë: metil hidroksibenzoat, metabisulfit natriumi, klorur natriumi dhe ujë për injeksion.

Përmbajtja e paketimit
Kuti kartoni me 10 ampula 2 ml.

Shpjegues i ikonave ilustruese për paketim:

Sipas recetës së mjekut.
Përmbajtja. Kujdes.
Tretësirë për injeksion.

Mbajtësi i autorizimit për tregtim (MAT) dhe prodhuesi:

PROFARMA Sh.a.
Rruga "Myslym Keta"
Tel.Fax: 00 355 4 23 62 800
Tiranë - SHQIPËRI

Ky fletëudhëzues u rishikua për herë të fundit në Shtator 2014.

SPECIFICATION

CROPING AREA 12 x 19 cm

PAY ATENTION, all the layers are visible.
If you have to print this document please check or uncheck the specific layers.